REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr.3778 Prot

Maliq, më 17.6.2026

PROJEKT-VENDIM - NR. 89

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR VENIEN NË DISPOZICION TË TRUALLIT PËR NDËRTIMIN E ZYRËS SË MARRËDHËNIEVE ME KONSUMATORËT NGA UJËSJELLËS KANALIZIME

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1.2 gërma b dhe c, nenit 23, nenin 54, nenin 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Kërkesës Nr.710 prot, datë 01.06.2026, të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë Sh.a,

PROPOZOJMË:

1. Për fillimin e procedurave për venien në dispozicion të truallit për ndërtimin e Zyrës së Marrëdhënieve me Konsumatorët nga Ujësjellës-Kanalizime sipas planvendosjes dhe planit të rilevimit bashkëngjitur këtij projekt-vendimi.
   - Pasuria Nr.3/590, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 510 m^2.

2. Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, të kryeje verifikimet e dokumentacionit ligjor (statusit juridik) pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të pasurisë që preken nga zbatimi i projektit, si dhe të vijojë procedurat e metejshme të përgatitjes së dokumentacionit të plotë që nevojitet.

3. Për zbatim ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq.

Konceptoi: J. Thomo Dt. 17 / 6 /2026

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 17 / 6 /2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

3778

Maliq, më 17.6.2026

Lënda: Për fillimin e procedurave për venien në dispozicion të truallit për ndërtimin e Zyrës së Marrëdhënieve me Konsumatorët nga Ujësjellës-Kanalizime

Drejtuar: **Këshillit të Bashkisë Maliq**

Në mbështetje të kërkesës Nr. 710 prot., datë 01.06.2026, të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë Sh.a., si dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, paraqitet për shqyrtim projekt-vendimi për fillimin e procedurave të vënies në dispozicion të truallit për ndërtimin e Zyrës së Marrëdhënieve me Konsumatorët.

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve administrative dhe teknike nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime.

Sipas planvendosjes dhe planit të rilevimit bashkëngjitur projekt-vendimit, prona e propozuar është Pasuria Nr. 3/590, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 510 m².

Përpara vijimit të procedurave administrative dhe ligjore, Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve do të kryejë verifikimin e dokumentacionit ligjor dhe të statusit juridik të pasurisë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastës.

Miratimi i këtij projekt-vendimi krijon bazën administrative dhe ligjore për vijimin e procedurave për vendosjen në dispozicion të truallit, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve publike dhe në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

Konceptoi: J. Thomo Dt. 17/6/2026

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 17/6/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : KOMBINATI I SHEQERIT MALIQ SHA | DATE 10.06.2026 | QËLLIMI:Ndarje Pasurie

VENDNDODHJA

BASHKIA MALIQ | DVASHK/ZVASHK KORCE | ZONA KADASTRALE:2573 | NUMRI PASURISE 3/590 | INDEX HARTES MQ-D-4

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: Truall | SIP.PASURISE=28800m2 | SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT _m2 | NUMRI KATEVE_k | NUMRI PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 558779.49
Y 4508625.03

X 558919.84
Y 4508625.03



X 558779.49
Y 4508520.83

SH 1:500

X 558919.84
Y 4508520.83

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI		NR PASURIE	3/303, 1/186		
2	LINDJE		NR PASURIE	3/273		
3	JUG		NR PASURIE	3/273		
4	PERENDIM		NR PASURIE	3/300		

REALIZOI PER BASHKINE MALIQ

EMRI:Mevlan LAME

NENSHKRIMI/VULA _____

MIRATOI

DREJTORI:Johand SULO

NENSHKRIMI / VULA _____

KONFIRMOI

KRYETARI I BASHKISË: GËZIM TOPÇIU

NENSHKRIMI / VULA _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O,

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto;
G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: P; HK

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve;
K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht;

PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

Parcela 1=28290m2.Pronar:Bashkia Maliq.

Parcela 2= 510m2.Pronar:Bashkia Maliq.